

KONTRATE
(për shitje të kuotave)

Sot, në Tiranë, më datë 02. 07. 2025 (dymijë e njëzet e pesë), përpilohet dhe regjistrohet ne regjistrin e shoqërisë kjo kontrat shitblerje midis:

PALË SHITËSE:

1. **Beqir NUREDINI**, atesia Xheladin, amësia Mirjana, i lindur me 29. 06. 1984 ne Rogozhine, Durres, banues në adresën: Rruga «Janosh Huniadi», Nd. 29; H. 5; Ap. 17; Njësia Administrative Nr. 5; Tiranë, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i dokumentit identifikues numer BC7339533 dhe numer personal I40629204Q.

Ne kete akt ne cilesine e Titullarit te Pasurise objekt kontrate.

Këtu e në vijim, Pala Shitëse.

PALË BLERËSE:

1. **Flamur SALIJA**, atësia Zelul, i lindur më 16.07.1972, në Carshovë, Përmet dhe banues në Tiranë, rruga «Kongresi i Përmetit», madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas Shqiptar, mbajtës i dokumentit identifikues numer BJ9155686 dhe numër personal H207160891.
2. **Klodian HAXHIU**, atësia Shaban, lindur me 11.08.1976 ne Peqin, banues ne Tirane, rruga Irfan Tershana, madhor e me zotesi te plote juirdike per te vepruar, mbajtes i dokumentit identifikues numer BJ4095369 dhe numer personal H60811081S.

Këtu e në vijim "Palë Blerëse"

I. BAZA LIGJORE

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, më posaçërisht nenet 659 e vijues të tij;
- Ligji Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", më posaçërisht nenet 72-75 te tij;
- Statuti i Shoqërisë "UNIVERS PROMOTIONS" Shpk

III. RRETHANA PARAPRAKE

1. Pala Shitëse deklaron se ka në pronësi:

TRIDHJET E PESË PËRQIND (35%) TË KAPITALIT të Shoqërisë Tregtare "UNIVERS PROMOTIONS" Shpk, identifikuar me NUIS: K81324039M.

Faktin e vërteton me aktin Ekstrakt i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit, lëshuar elektronikisht nga QKB, përftuar nga Platformen e- Albania.

- 2- Ekstrakt i regjistrit tregtar evidenton se Shoqëria "UNIVERS PROMOTIONS" Shpk e regjistruar si person juridik shqiptar me përgjegjësi te kufizuar, e identifikuar me numer NUIS: K81324039M, ka status aktiv.
- 3- Shoqëria "UNIVERS PROMOTIONS" Shpk zotërohet në bashkëpronësi nga ortakët:
 - 1- Beqir NUREDINI => Pjesa takuese (35%) e Kapitalit të Shoqërisë;
 - 2- Flamur SALIJA => Pjesa takuese (35%) e Kapitalit të Shoqërisë;
 - 3- Klodian HAXHIU => Pjesa takuese (30%) e Kapitalit të Shoqërisë;
- 4- Shoqëria "UNIVERS PROMOTIONS" Shpk me Vendimin Nr.: 02-K-2025, datë 02.07.2025 në menyrë të shprehur ka miratuar shitblerjesn e kuotave midis ortakëve.
- 5- Pala Blerëse / Flamur SALIJA dhe Klodian HAXHIU, të dy ortak në shoqëri, deklarojnë se janë plotësisht te njohur me sendin objekt kontrate, e kane shqyrtuar dokumentacionin dhe përmbajtjen e këtij akti.
- 6- Palët, seicila deklaron se është plotësisht e njohur me llojin e aktit, pasojat juridike të tij dhe ka marrë paraprakisht dhe privatisht konsulencën e duhur juridike e fiskale.

Në deklaram, njohje e pranim të plotë të sa më sipër Palët kontraktuese, me kerkese të shprehur të tyre, me vullnetin e lire, te plote, e të pa vesuar bien dakord të hartojnë këtë kontratë shitje me rezervë sipas kushteve dhe kritereve të mëposhtme:



NENI 1

OBJEKTI I KONTRATES

- 1.1. Vendoset Shitja nga Pala Shitese / **Beqir NUREDINI** dhe Blerja nga Pala Blerese / **Flamur SALIJA**, i pasurisë:

Një Pjese të barabartë me **25,00 %** (njëzet e pesë përqind) të kapitalit nga pjesa totale prej 35% që Beqir NUREDINI zoteron ne shoqeri.

- 1.2. Vendoset Shitja nga Pala Shitese / **Beqir NUREDINI** dhe Blerja nga Pala Blerese / **Klodian HAXHIU**, i pasurisë:

Një Pjese të barabartë me **10,00 %** (dhjetë përqind) të kapitalit nga pjesa totale prej 35% që Beqir NUREDINI zoteron ne shoqeri.

NENI 2

ÇMIMI I SHITBLERJES DHE MENYRA E PAGESES

- 2.1. Palët bien dakort dhe përcaktojnë se **Çmimi per shitblerjen** nga Pala Shitese / **Beqir NUREDINI** tek Pala Blerëse / **Flamur SALIJA** i Pjesës prej **25 % të Kapitalit do të jetë: ALL: 7,000,000. (shtatedhjetë milion Lek)**
- 2.2. Palët bien dakort dhe përcaktojnë se **Çmimi per shitblerjen** nga Pala Shitese / **Beqir NUREDINI** tek Pala Blerëse / **Klodian HAXHIU** i Pjesës prej **10 % të Kapitalit do të jetë: ALL: 3,000,000. (tre milion Lek).**
- 2.3. Palët deklarojnë se çmimi i shitblerjes do te likuidohet përmes transfertës bankare ne llogarinë e **Beqir NUREDINI** (Palë Shitëse) prane bankes CREDINS Bank sha, identifikuar si:
Valuta ne: LEKE Nr. Llogarie: 00001373854
IBAN: AL74212110160000000001373854 SWIFT: CDISALTRXXX
Pagesa e Çmimi të Shitblerjes vërtetohet me dokument bankar.

NENI 3

GJENDJA E RE PRONËSORE

- 3.1. Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe pagesën e Çmimit të Shitblerjes ortakut **Beqir NUREDINI** del nga shoqëria, dhe Shoqeria Tregtare "UNIVERS PROMOTIONS" Sh.p.k. do të zotërohet nga:
1. Flamur SALIJA, zoterues i **60%** (gjashtëdhjet për qind) te kapitalit te shoqerise;
 2. Klodian HAXHIU, zoterues i **40%** (dyzet për qind) te kapitalit te shoqerise;

NENI 4

RREGJISTRIMI I AKTIT

- 4.1. Palet bien dakort dhe percaktojne se ky akt do te depozitohet pranë QKB per te bere te mundur kalimin ne favor të Blerëve te pronësisë edhe mbi pasurine.

NENI 5

TE DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

- 5.1. Pala Shitëse me dëshirë te lirë e të plotë deklarën se pronën e përshkruar me sipër ia shet Palës Blerëse, e cila deklarën se dëshiron dhe është dakord që ta blejë konform kushteve te vendosura në këtë akt.
- 5.4. Tarifat, taksat dhe Komisionet bankare paguhen sipas ligjit.

NENI 6

NJOFTIMET

Të gjitha njoftimet mes palëve për zbatimin e kësaj kontrate do të bëhen me shkrim në adresat postare të dhëna nga palët në hyrje të aktit.

Palët bien dakord që njoftimet e bëra në adresat e shkëmbyera më sipër, në këtë kontratë janë plotësisht të vlefshme dhe se dërgimi i njoftimit në këto adresa ka vlerë shkresore dhe provuese të plotë të dërgueshmërisë së njoftimit.



Palët sipërmarrin të njoftojnë paraprakisht me shkrim, njëra tjetrën në rast të ndërrimit të adresës fizike postare, dhe të personit të kontaktit. Është detyrim i palëve të sigurohen që kanë dhënë, dhe i mbajnë të përditësuara adresën e saktë dhe personin e saktë të kontaktit.

Kontrates i bashkengjitet kopje te akteve:

- ✓ Ekstrakt i regjistrimit tregtar;
- ✓ Vendimi Nr.: 02-K-2025, datë 02.07.2025 i Asamblesë së Shoqerisë;
- ✓ Çertifikatat dhe Dokumentacioni i identifikimit të paleve.

Individërt palë në akt, secili me vullnet të lire dhe të plotë e nënshkruan këtë Kontrat Shitblerje Kuotash.

PALË SHITËSE

1. Beqir NUREDINI

Beqir Nuredini



PALË BLERËSE

1. Flamur SALIJA

Flamur Salija

2. Klodian HAXHIU

Klodian Haxhiu

